



VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 27 maj 2014

Numri i lëndëve: 2012-19 dhe 2012-20

H dhe G

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut përmes mjeteve elektronike në përputhje me rregullën 13 të rregullores së vet të punës më 27 maj 2014 me anëtarët e paraqitur si në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. Vendimi i Panelit i datës 30 shtator 2013

1. Më 30 shtator 2013, Paneli ka marrë vendim në lidhje me ankesat e paraqitura nga H dhe G sa i përket një sërë incidentesh që kishin ndodhur gjatë ngjarjeve të *Vidovdanit* në qershor të vitit 2012. Paneli ka gjetur se disa nga shkeljet e pretenduara nga ankuesit ishin vërtetuar dhe ju ishin ngarkuar EULEX-it. Këto kishin rezultuar në shkeljen e të

drejtave të ankuesve sipas neneve 8, 9 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), si dhe neneve 17, 18, 21 dhe 22 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).

2. Në vendimin e tij, Paneli ka bërë një sërë rekomandimesh për shefin e misionit (ShM) në pajtim me rregullën 34 të rregullores së punës si në vijim:
 - i. Që ShM të pranoj se të drejtat e ankuesve janë shkelur nga EULEX-i.
 - ii. Që ShM të kërkoj nga të gjitha degët dhe organet përkatëse të EULEX-it, të cilat posedojnë informacione në lidhje me ngjarjet e Vidovdanit të vitit të kaluar, t'i sigurojnë një pasqyrë të plotë të veprimeve të EULEX-it gjatë këtyre ngjarjeve. Mbi këtë bazë, ShM të siguroj që çdo informacion në posedim të EULEX-it lidhur me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut të kryera në këtë kontekst (përfshirë çdo shkelje që i ngarkohet zyrtarëve të PK-së) t'ju ofrohet autoriteteve kompetente të Kosovës për veprime dhe hetime të mëtutjeshme. Nëse EULEX-i më vonë përcakton se rastet e tilla nuk ishin hetuar plotësisht dhe në mënyrë të duhur, EULEX-i të merr në konsideratë marrjen përsipër të përgjegjësisë së hetimit të këtyre rasteve.
 - iii. ShM ftohet të hulumton me autoritetet kompetente hetuese dhe prokuroriale në EULEX nëse mund të merren hapa hetimor në lidhje me incidentin që përfshihen ankuesit H dhe G.

Paneli fton ShM t'i njoftoj ankuesit drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve kompetente hetimore të EULEX-it rreth rezultatit të këtyre hetimeve. Ankuesit janë të lirë të raportojnë në Panel ndonjë çështje të pazgjidhur kur kontaktohen nga EULEX-i.

- iv. Nëse EULEX-i luan ndonjë rol në festimet e Vidovdanit në vitin 2014, ShM të siguroj që autoritetet kompetente të EULEX-it:
 - a) të kryejnë një vlerësim të rrezikut me qëllim të krijimit dhe identifikimit të burimeve të mundshme të rreziqeve ndaj mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut të pjesëmarrësve në festimet e Vidovdanit. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të EULEX-it t'ju drejtohen dhe t'i mësojnë mësimet nga dobësitë e identifikuar gjatë operacionit të Vidovdanit në qershor të vitit 2012 dhe siç janë regjistruar në vendimin e tanishëm;
 - b) të paraqesin tek ShM një plan të hollësishëm në lidhje me përfshirjen e EULEX-it në festimet e ardhshme të Vidovdanit më 28 qershor 2013. Një plan i tillë të përfshijë një përshtetje të hollësishme të mjeteve dhe burimeve të nevojshme për të siguruar që zyrtarët e EULEX-it të kryejnë përgjegjësitë ekzekutive në mandatin e tyre në mënyrë efektive, në veçanti në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut të pjesëmarrësve në këto ngjarje. Kjo do të përfshijë, nëse është e nevojshme, mundësinë që zyrtarët e EULEX-it të thërrasin përforcime. Kjo planifikon që gjithashtu të përfshihen mjete të duhura të komunikimit dhe transportit për të siguruar se është e mundur ndërhyrja e shpejtë kur është e nevojshme me qëllim të parandalimit apo të dhënies fund të shkeljeve të të drejtave të njeriut;

- c) të sigurojnë bashkërendim të duhur ndërmjet misionit të EULEX-it në njërën anë dhe PK-së dhe autoriteteve kompetente të Kosovës në anën tjetër, në mënyrë që të ketë mbrojtje efektive të pjesëmarrësve gjatë këtyre festimeve. Gjithashtu EULEX-i të siguroj që zyrtarët e PK-së të përfshirë në rastet e tilla të jenë plotësisht të vetëdijshëm se ushtrimi i dhunës mbi pjesëmarrësit nuk do të tolerohet dhe se do të vendosen mekanizmat e përgjegjësive për të ndëshkuar keqbërësit;
 - d) në përputhje me burimet që janë në dispozicion për qëllime të tilla në mënyrë të arsyeshme, të caktojnë për këtë detyrë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve të EULEX-it, në proporcion me rëndësinë e këtyre ngjarjeve të Vidovdanit dhe në përputhje me rrezikun potencial të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
 - e) të ofrojnë udhëzime dhe urdhra të qarta për të gjithë zyrtarët e policisë së EULEX-it të përfshirë në këtë operacion, posaçërisht në lidhje me rrethanat në të cilat ata mund të jenë të detyruar të ndërhyjnë për të mbrojtur të drejtat e njeriut të pjesëmarrësve.
 - v. Lidhur me hetimin dhe raportimin e mundshëm për sjellje të keqe, ShM po ashtu të siguroj që zyrtarët e EULEX-it të përfshirë në operacionin e Vidovdanit të regjistrojnë me kujdes secilin rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut që mund ta shohin apo që mund t'ju raportohet atyre. EULEX-i nga ana tjetër të hetoj secilin prej këtyre incidenteve të dyshuara dhe/ose ta transmetojnë këtë informacion tek autoritetet kompetente hetimore të Kosovës me qëllim që të sigurohet hetim efektiv i çfarëdo rasti të tillë.
3. Vendimi i tanishëm e pason vendimin e Panelit të datës 30 shtator 2013 dhe rekomandimeve të bëra aty. Kompetenca dhe autoriteti i Panelit për t'i përcjellë vendimet dhe rekomandimet e tij është paraparë në rregullën 45 e tutje të rregullores së punës së Panelit (shih p.sh. vendimet për zbatimin e rekomandimeve [A,B,C&D kundër EULEX-it](#), 2012-09, 2012-10, 2012-11 & 2012-12, 5 shkurt 2014; [W. kundër EULEX-it](#), 2011-07, 25 nëntor 2013; [Djeljali Kazaqic kundër EULEX-it](#), 2010-01, 23 nëntor 2011 dhe [Blerim Rudi kundër EULEX-it](#), 2010-07, 23 nëntor 2011).

II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

- 4. Më 26 nëntor 2013, ShM ka informuar Panelin rreth një sërë masash që i kishte marrë në lidhje me rekomandimet e Panelit.
- 5. Në veçanti, ShM ka informuar Panelin se ai kishte kërkuar një rishikim të plotë të veprimeve të EULEX-it gjatë atyre ngjarjeve si dhe të operacioneve të EULEX-it në lidhje me *festimet e Vidovdanit* të datës 28 qershor 2012. Në këtë kontekst, shefi i misionit iu ka drejtuar parashtrësave të tij të datës 20 gusht 2013 në lidhje me lëndët [A,B,C&D kundër EULEX-it](#) (krahasoni par. 5 dhe 7 deri në 12), të cilat kanë të bëjnë me të njëjtat ngjarje të përgjithshme. ShM ka saktësuar se parashtrësat e tij nuk lidhen vetëm me lëndët A, B, C & D, mirëpo ato lidhen edhe me lëndët H & G. Në mënyrë të veçantë u theksuar se ShM kishte udhëzuar të gjithë zyrtarët e EULEX-it për të regjistruar me kujdes çfarëdo shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut që ata mund të

shohin. Zyrtarëve të EULEX-it ju ishte kërkuar që të udhëzojnë vartësit e tyre se kur duhet të shpërndahet një informacion i tillë me autoritetet vendore. Si rezultat i këtyre veprimeve që janë ndërmarrë tashmë si vazhdim i këtyre lëndëve, posaçërisht rreth festimeve të *Vidovdanit* të vitit 2013, është besuar se EULEX-i ka vepruar në përputhje me rekomandimet e Panelit.

6. Gjithashtu ShM ka informuar Panelin se duke pasur parasysh shqyrtimin e vazhdueshëm strategjik të misionit, ai nuk do të mund të angazhohet rreth ndonjë mase operative në lidhje me festimet e *Vidovdanit* të vitit 2014, në këtë fazë. Megjithatë, është vërtetuar se nëse EULEX-i luan ndonjë rol në festimet e *Vidovdanit* të vitit 2014, rekomandimet e Panelit do të merren parasysh.
7. Në lidhje me ankuesit H&G, EULEX-i nuk mund të gjej ndonjë informacion të veçantë që mund të ishte dorëzuar më pas tek autoritetet e Kosovës për veprime të mëtejshme hetimore. Për këtë arsye, ShM ka kërkuar ndihmën e Panelit për të marrë informacion të mëtejshëm lidhur me identitetin e ankuesve. Pas këtyre përpjekjeve, më 26 maj 2014, ShM ka informuar Panelin se më 12 mars 2014, EULEX-i ka dorëzuar raporte në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK). Ky raport ishte dërguar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë në kopje nga kryeprokurori i shtetit të Kosovës. Kryeprokurori i shtetit iu është përgjigjur EULEX-it se zyra e tij kishte kërkuar nga kryeprokurori në Gjykatën Themelore në Prishtinë të ndërmerr masat e përcaktuara me ligj.
8. Pas një kërkesë nga IPK-ja, stafi i EULEX-it është takuar me hetuesit e IPK-së më 1 prill 2014. IPK-ja ka informuar EULEX-in se ata kanë ndërmarrë një sërë masash hetimore në këtë lëndë, duke përfshirë intervistimin e disa ankuesve lidhur me ngjarjet në *Vidovdanin* e vitit 2012.

III. INFORMACIONI NGA ANKUESIT

9. Ankuesit nuk kanë komentuar mbi veprimet e ndërmarra nga ShM.

IV. VLERËSIMI NGA PANELI

10. Paneli konstaton hapat e ndërmarra nga ShM për të zbatuar shumicën e rekomandimeve të Panelit.

Pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut

11. Si në vendimet e mëparshme, Paneli konstaton se zyrtarisht ShM nuk e ka pranuar shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesve, pavarësisht prej rekomandimit nga Paneli për një gjë të tillë.
12. Paneli thekson edhe një herë se pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga shtetet është një praktikë e krijuar mirë në procedurat, *ndër të tjera* të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (shih për këtë

rregullën 62 A të [rregullores së Gjykatës](#)). Një praktikë e ngjashme e pranimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut zbatohet rregullisht nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) i UNMIK-ut (shih për shembull në vendimin më të fundit deri më sot të PKDNj-së, *MITIĆ kundër UNMIK-ut*, lënda nr. 064/09e datës 14 mars 2014 në par. 43).

13. Duke pasur parasysh faktin se Paneli nuk mund të rekomandojë që t'i paguhet viktimës kompensim financiar, Paneli fton ShM t'i përdor mjetet juridike që janë në dispozicion të tij. Në disa raste, pranimi formal i shkeljes së të drejtave lejon që të sigurohet ndonjë kompensim për viktimën e asaj shkeljeje. Duke marrë parasysh kufizimet e vendosura mbi kompetencën e Panelit për të rekomanduar kompensim financiar siç është përcaktuar në Konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, pranimi formal i një shkeljeje nga autoriteti kompetent bëhet e tëra mbi të gjitha si një formë korigjimi.

Masat operative të ndërmarra në lidhje me festimet e Vidovdanit

14. Paneli rithekson gjetjet e veta në lidhje me masat operative të ndërmarra nga EULEX-i në lidhje me festimet e *Vidovdanit* gjatë vitit 2013 (shih vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve [A,B,C&D kundër EULEX-it](#), 2012-09, 2012-10, 2012 -11 & 2012-12, 5 shkurt 2014 në paragrafët 18-24) dhe ato i konsideron se përbëjnë një zbatim të duhur të rekomandimeve të Panelit.
15. Në bazë të festimeve të ardhshme të *Vidovdanit* më 28 qershor 2014, Paneli më tej rekomandon ShM që të shqyrtoj rekomandimet e vendimeve të tij të mëparshme në lidhje me festimet e *Vidovdanit* (shih [A,B,C&D kundër EULEX-it](#) 2012-09, 2012-10, 2012-11 & 2012-12, i datës 20 qershor 2013, si dhe [H&G kundër EULEX-it](#), 2012-19 & 2012-20). Kjo duhet t'i ndihmojë ShM në përcaktimin e obligimeve konkrete të EULEX-it ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me festimet e *Vidovdanit* të vitit 2014. Një vlerësim i tillë duket të jetë i një rëndësie të madhe në bazë të mandatit të ri të EULEX-it. Duke vepruar kështu, EULEX-i do të tregoj angazhimin e tij për të siguruar se rreziku i shkeljes së të drejtave të njeriut të individëve është marrë seriozisht dhe se janë ndërmarrë hapa për t'i parandaluar ato ndodhi.

Hetimet

16. Paneli konstaton se ShM ka ndërmarrë një sërë hapash për të siguruar që rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut të konstatuara nga Paneli në vendimin e tij të datës 30 shtator 2013 janë duke u hetuar dhe se autoritetet lokale përfshirë Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe IPK-në janë informuar siç duhet. Në këto rrethana, Paneli konsideron se këto hapa përbëjnë zbatim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm të rekomandimit të Panelit.
17. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

PANELI NJËZËRI,

Shpall se ShM-ja ka ushtruar funksionet e tij me zell dhe në mënyrë efektive në zbatimin e shumicës së rekomandimeve të Panelit. Më tej, Paneli fton ShM të rishqyrtojë pozicionin e tij në lidhje me mundësinë që t'i pranoj shkeljet e të drejtave të ankuesve, atëherë kur Paneli i bën ato rekomandime për atë qëllim.

Vendos që ta mbyll shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda Mierzewska
Kryesuese